



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Kom.Dh.Shk.II.nr.1253/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.SH “...”, me seli në Prishtinë, ..., përfaqësuar sipas autorizimit nga Korab Rexhepi, avokat në Prishtinë, kundër debitorit Radio Televizioni i Kosovës, me seli në Prishtinë, përfaqësuar sipas autorizimit nga firma e avokatisë Judex, - Av.Florim Lata, për shkak të borxhit, në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.1048/2015 të dt. 25.06.2018, jashtë seancës më datën 09.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET poshtë si e pasafatshme ankesa e kreditorit N.SH ..., me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.1048/2015 të dt. 25.06.2018.

A R S Y E T I M

Gjykata e shkallës së parë, me Aktvendimin e ankimuar PPP.nr.1048/2015 të dt. 25.06.2018, ka vendosur si në vijim: “I.Aprovohet si e bazuar prapësimi i debitorit Radio Televizioni i Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Firma e Avokatisë Judex, av. Florim Lata, i ushtruar kundër urdhrit të Përmbartuesit Privat Flamur S. Bogaj, P.nr.638/18 dt. 27.10.2015, Shfuqizohet urdhri i përmbartuesit Flamur S. Bogaj P.nr.638/15 dt. 27.10.2015, abrogohen të gjitha veprimet e ndërmara deri me tani në këtë çështje përmbartimore.”

Kundër këtij aktvendimi, ka ushtruar ankesë kreditori dhe atë për shkak të shkeljeve së dispozitave të procedurës përmbartimore, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet ankesa e kreditorit si e bazuar, të anulohet aktvendimi i atakuar dhe lejohet vazhdimi i procedurës përmbartimore sipas urdhrit të Përmbartuesit Privat P.nr.638/15 dt. 27.10.2015 dhe obligohet

debitori t'ia kompensoj kreditorit të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore, duke përfshirë edhe shpenzimet për përpilimin e ankesës.

Ankesa i është dorëzuar në mënyrë të rregullt debitorit, mirëpo i njëjti nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata Komerciale e Kosovës–Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pasafatshme

Nga shkresat e lëndës konstatohet se kreditori ka paraqitur me datën 27.10.2015, tek përmbartuesi privat propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm faturës, për shumë e borxhit në vlerë prej 494.168.00 Euro.

Përmbartuesi privat sipas propozimit të kreditorit ka nxjerr Urdhrin përmbartimor P.nr.638/18 dt. 27.10.2015, ndaj të cilit debitori ka paraqitur prapësim. Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori, duke i propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi dhe të lejohet vazhdimi i procedurës së përmbartimit.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas prapësimit të debitorit ka nxjerr aktvendimin e atakuar PPP.nr.1048/2015 të dt. 25.06.2018, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit.

Ndaj aktvendimit të atakuar i autorizuari i kreditorit ka paraqitur ankesë, për të cilën Gjykata Komerciale gjeti se është e pasafatshme dhe vendosi që të njëjtën ta hedh poshtë.

Gjykata Komerciale–Dhoma e shkallës së dytë fillimisht e vlerësoj afatshmërinë e ankesës dhe gjeti se ankesa e të autorizuarit të kreditorit është e pasafatshme sepse aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë i autorizuari i kreditorit e ka pranuar me datën 01.09.2020, rrethanë e cila konfirmohet nga fletë kthesa në shkresat e lëndës, ndërsa ankesën i autorizuari i kreditorit e ka paraqitur më datën 09.09.2020, e konfirmuar nga vula e pranimit në zyrën postare (.....). Duke qenë se kreditori, aktvendimin e atakuar e ka pranuar me datën 01.09.2020, rrjedh së dita e fundit e afatit për paraqitjen e ankesës ka qenë data 08.09.2020 (ditë e martë), sepse me dispozitën e nenit 77 paragrafi 2, i LPP-së, parashihet se afati për paraqitjen e ankesës është shtatë ditor.

Për të vendosur si në dispozitivin e këtij aktvendimi Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, ju referua dispozitave të LPK-së, nga neni 186 paragrafi 2, me të cilën përcaktohet së: *“ankesa është e pasafatshme po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e saj”* ndërsa me dispozitën e nenit 196 të LPK-së, parashihet së: *“ ankesën e vonuar, jo të plotë, apo jo të lejueshme, e hedhë poshtë gjykata e shkallës së dytë, me aktvendim, po që se nuk e ka bërë një gjë të tillë gjykata e shkallës së parë siç parashihet me nenin 186”*.

Nga arsyet e mësipërme, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale në Prishtinë, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi pasi që gjeti së ankesa e kreditorit është e pasafatshme, të cilën kjo gjykatë e hedhi poshtë në pajtim me nenin 186 paragrafi 2, 196 dhe 209 pika (a) të LPK-së, dhe e lidhur me nenin 17 të LPP-së, duke vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e shkallës së dytë

Kom.Dh.Shk.II.nr.1253/22 dt. 09.09.2022

Gjyqtari,
Krenar Berisha